



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 mars 2022
Nr. ref.:AGJ 1962/22

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI49/20

Parashtrues

Shehide Muhadri

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së
Apelit të Kosovës Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shehide Muhadri, me vendbanim në fshatin Babush i Muhaxherëve, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe shkeljet e nenit 2 paragrafi 1 pika a) të Ligjit kundër Diskriminimit.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 10 mars 2020, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 28 maj 2020, godine, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullin 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të

Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

10. Më 8 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit GJR. KI49/20, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Gresa Caka-Nimani, e cila, më 17 maj 2021, u zgjodh Kryetare e Gjykatës.
11. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit numër KSH. KI49/20, caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani anëtare të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Bajram Ljatifi.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe kërkoi plotësimin e raportit.
14. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Në fillim të shqyrtimit të fakteve, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës parashtron kërkesë në Gjykatë për herë të dytë. Kërkesën e parë, parashtruesja e parashtrroi së bashku me personat M.M. dhe S.I., e cila është regjistruar nga Gjykata me shenjën KI145/18. Në kërkesën KI145/18, parashtruesit e kërkesës kontestuan kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018. Në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsytuar gjyqësor, duke e shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar dhe duke e kthyer rastin për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit. Rasti i tanishëm ndërlihet me Aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata e Apelit si pasojë e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18.
16. Duke pasur parasysh këtë, dhe me qëllim të shqyrtimit dhe kuptimit më të qartë të kërkesës KI49/20, Gjykata në vazhdim të vendimit të saj do të paraqesë edhe faktet nga kërkesa KI145/18, për të cilën tashmë ka vendosur.

Përmbledhja e fakteve në rastin KI145/18

17. Kërkesa në fjalë dhe për të cilën Gjykata tashmë ka vendosur në rastin KI145/18, kishte të bënte me disa paluajtshmëri, përkatësisht me ngastrat kadastrale nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të evidentuara në fletën poseduese nr. 169 ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna e Lipjanit.

Paluajtshmëritë në fjalë janë blerë nga Komuna e Lipjanit, nga disa pronarë privat (në vitet e 60-ta). Mjetet për blerjen e tyre i kishte siguruar “Fondi Ndërkombëtar për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”, me seli në Gjenevë të Zvicrës, me qëllim të strehimit dhe integritit të refugjatëve të ardhur nga Shqipëria në vitet e 60-ta. Këto paluajtshmëri iu dhanë më pas në shfrytëzim me mirëbesim parashtrueseve të kërkesës në vitin 1969. Megjithatë, pronësia mbi këto paluajtshmëri që nga ajo kohë kishte mbetur e regjistruar në emër të Komunës së Lipjanit.

18. Më 25 shkurt 2009, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Lipjan, me të cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë mbi paluajtshmëritë e lartcekura, me pretendimin se të njëjtat i kanë fituar me posedim të ligjshëm prej vitit 1969, nga Komuna e Lipjanit, në bazë të kontratës Vr. nr. 248/68, të 17 qershorit 1968.
19. Më 16 gusht 2010, Gjykata Komunale në Lipjan, me Aktgjykimin C. nr. 48/2009, aprovoi padinë e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi se të njëjtat e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit të ligjshëm mbi paluajtshmëritë nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në fletën poseduese nr. 169 ZK Babush i Muhaxherëve. Me këtë aktgjykim, gjykata e detyroi të paditurën, Komunën e Lipjanit, që parashtruesve të kërkesës t’ua njohë të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmëritë në fjalë dhe të lejojë regjistrimin e tyre në pronësi të parashtruesve të kërkesës, në regjistrat e paluajtshmërive në Komunën e Lipjanit, Zona Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
20. Gjykata e shkallës së parë në Aktgjykimin e saj arsyetoi si në vijim: *“Mbi bazën e [këtyre] fakteve gjykata në mbështetje të dispozitave nga neni 28 al. 4 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësoro-Juridike vjen në përfundim se paditësit si posedues të ndërgjegjshëm e kanë fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese të përshkruar në pikën I të dispozitivit me kalimin e kohës prej 20 viteve si posedues me mirëbesim, edhe përkundër faktit se kjo paluajtshmëri është e regjistruar në librat e Operatit Kadastral në emër të paditurës, pasi që me nenin 16 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Bazë Pronësoro-Juridike nr. 29 të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSJ-së nr. 29/1996 me të cilën dispozitë është fshirë neni 29 i Ligjit në fjalë i cili ka paraparë se në sendet në pronësi shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me mbajtje, ashtu që pas fshirjes së kësaj dispozite ligjore prona shoqërore dhe ajo private janë barazuar në pikëpamje të fitimit të së drejtës së pronësisë me mbajtje”.*
21. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Lipjanit parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 14 nëntor 2014, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 1855/12 e prishi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të njëjtin e ktheu në rigjykim dhe rivendosje, me arsyetimin se: *“...vlerësimi juridik i gjykatës të shkallës së parë se në bazë të institutit të parashkrimit fitues pala paditëse e ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të nenit 28 par. 4 të LMTHJP-së, e lidhur me nenin*

16 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, nuk mund të qëndron, për arsye se edhe në bazë të dispozitave të Ligjit të punës së bashkuar, rregullave juridike të së drejtës civile dhe nenit 29 të LMTHJP-së e drejta e pronësisë në pronësinë shoqërore nuk mund të fitohet në bazë të parashkrimit fitues“.

23. Më 11 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan, bashkoi dy padi, atë të parashtruesve të kërkesës dhe të disa paditësve të tjerë, të cilët po ashtu kërkuan vërtetimin e pronësisë së paluajtshmërive të lartcekura, dhe me një lëndë të vetme vendosi:

1) *“të refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës me të cilën kërkuan vërtetimin e pronësisë së ngastrave me nr. 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në ZK Babush i Muhaxherëve, në fletën poseduese me numër 169, me arsyetimin se “Meqenëse në rastin konkret paditësit Shehide Muhadri, Murat Muhadri dhe Sylë Ibrahim i nga fsh. Babush i Muhaxherëve, me asnjë provë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nuk e kanë argumentuar mënyrën e fitimit të pronësisë për paluajtshmërinë e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, siç parashohin dispozitat e lartcekura për këtë arsye gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi“,*

2) *të refuzojë kërkesëpadinë e paditësve A.L., M.L. dhe A.L., nga Babushi i Muhaxherëve, të cilët po ashtu kërkuan vërtetimin e pronësisë së ngastrave me numër 173, 636, 638 dhe 641, të gjitha të regjistruara në ZK Babush i Muhaxherëve, mbi bazën e kontratës së shitblerjes së vitit 1966, me pretendim se paraardhësi i tyre ka paguar çmimin në emër të kaparit nga 1/3 e çmimit të përgjithshëm në lidhje me paluajtshmëritë në fjalë“.*

24. Më 29 dhjetor 2015, parashtruesit e kërkesës, kundër aktgjykimit të shkallës së parë, paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit e kërkesës në mënyrë të veçantë kërkuan nga gjykata në fjalë që rasti i tyre të trajtohet ngjashëm me disa raste të njëjta (të disa familjeve të tjera), të cilët kishin fituar të drejtën e pronësisë me anë të parashkrimit fitues.

25. Më 18 qershor 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 19/2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Lipjan, të 11 nëntorit 2015, me arsyetimin si në vijim:

“Për fitimin e të drejtës së pronësisë në mënyrë komplete duhet të plotësohen dy kushtet ligjore, të ekzistojë baza e vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë (neni 20 i ligjit të lartpërmendur), por përveç kësaj e drejta e pronësisë fitohet edhe me regjistrim në librat publike të patundshmërisë ose në mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj (neni 33 i po këtij ligji). Nga kjo rrjedh, se përveç bazës juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë duhet të ekzistojë edhe mënyra juridike e fitimit, e në këtë rast nuk ekziston nga fakti se patundshmëria ende evidentohet si pronësi shoqërore në emër të Komunës së Lipjanit.

Gjykata e shkallës së dytë e pranon vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, se në bazë të institutit të parashkrimit fitues, paditësit e parë nuk kanë mundur ta fitojnë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese edhe pse me dispozitën e nenit 16 të Ligjit mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e LMTHPJ-së, “Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/26”, i cili ka hyrë në fuqi më 05.07.1996 është përcaktuar se fshihet neni 29 i këtij ligji, mirëpo kjo dispozitë nuk mund të aplikohet në këtë çështje konkrete juridike por eventualisht ka mundësi të aplikohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në çështjen e paditësve kjo dispozitë nuk ka qenë në fuqi, kurse vlen parimi se në raportet juridike-civile aplikohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil. Sipas këtyre dispozitave duke marrë edhe për bazë dispozitat e Ligjit të Punës së Bashkuar, e drejta e pronësisë në pronësi shoqërore në asnjë rrethanë nuk mund të fitohet mbi bazën e parashkrimit. Nga arsyet e paraqitura gjykata vlerëson se paditësit e parë nuk kanë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për t’iu njohur e drejta e pronësisë sipas parashkrimit fitues dhe atë në bazë të nenit 28 të LMTHJP-së“.

26. Më 9 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës paraqitën në Prokurorinë e Shtetit propozimin për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, të 18 qershorit 2018, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 27 gusht 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përmes Njoftimit KMLC nr. 117/2018, njoftoi parashtruesit e kërkesës se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.
28. Më 31 gusht 2018, parashtruesit e kërkesës paraqitën në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit kërkesë për rishqyrtim të propozimit për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke u thirrur në diskriminim, përkatësisht trajtim të pabarabartë.
29. Në një datë të paspecifikuar, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit shqyrtoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës dhe arsyetoi: “...përsëri ju njoftojmë se ne kemi konstatuar se nuk kemi bazë ligjore për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, sepse ky mjet nga ana jonë mund të paraqitet vetëm nëse shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën rreth së cilës kontestimi i çështjes në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore ose nëse është bërë shkelja e të drejtës materiale. Në rastin konkret, sipas gjetjeve tona nuk qëndron asnjëra nga këto kushte ligjore për paraqitjen e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik”.
30. Më 2 tetor 2018, parashtruesja e kërkesës së bashku me personat M.M. dhe S.I., parashtrroi kërkesën në Gjykatë, e cila është regjistruar nga Gjykata me shenjën KI145/18.

31. Parashtruesit e kërkesës në kërkesën KI145/18 theksuan se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018, shkel të drejtat e tyre të garantuara me nenet 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
32. Më konkretisht, parashtruesit e kërkesës si pretendim kryesor në lidhje me shkeljen e të drejtave kushtetuese theksuan, *“se të drejtat e tyre janë shkelur nga gjykatat e rregullta sepse në rastin e tyre kanë marrë vendime të ndryshme në krahasim me disa raste identike të tjera. Parashtruesit e kërkesës pretenduan se e njëjta gjykatë (duke aluduar në ish-Gjykatën Komunale në Lipjan), ua njohu disa familjeve të tjera të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, ndërsa në rastin e tyre gjykatat nuk i morën parasysh rrethanat e njëjta faktike dhe juridike“.*
33. Më 19 korrik 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta shpallë kërkesën KI145/18 të pranueshme dhe të vlerësojë përmbajtjen e kërkesës.
34. Të njëjtën ditë, Gjykata nxori Aktgjykimin, në të cilin konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, i 18 qershorit 2018, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesve të kërkesës, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor, gjë që është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe rrjedhimisht e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 530/2016, të 18 qershorit 2018 dhe e ktheu të njëjtin në rivendosje, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës.
35. Më konkretisht, Gjykata, në Aktgjykimin KI145/18, konstatoi:

“[...] 57. se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për trajtim të pabarabartë para gjykatave, i cili ishte ngritur para gjykatave të rregullta ishte thelbësor dhe i mbështetur me dëshmi materiale i cili ngrente çështje nga neni 24 i Kushtetutës, përkatësisht çështjen epabarazisë së palëve para ligjit. Adresimi i duhur i pretendimit në fjalë nga ana e gjykatave të rregulltado e forconte bindjen e parashtruesve të kërkesës se ata janë dëgjuar në mënyrë të duhur, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të Konventës .

58. Sikur Gjykata e Apelit të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesvetë kërkesës për trajtim të pabarabartë nga ana e gjykatës së shkallës së parë - pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë do të përmbushej kushti i “palës së dëgjuar” dhe i administrimit të duhur të drejtësisë”.

Përmbledhja e fakteve në rastin KI49/20

36. Më 10 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit, duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18, mbajti rigjykimin në rastin në fjalë, dhe rrjedhimisht nxori Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016, në të cilin e refuzoi, si të

pabazuar, ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan-Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 19/2015, të 11 nëntorit 2015, e vërtetoi në tërësi.

37. Në arsyetimin e Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016, Gjykata e Apelit, në një pjesë të veçantë të Aktgjykimit, trajtoi në mënyrë të posaçme çështjet e ngritura dhe gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, të cilat për Gjykatën kanë qenë bazë për nxjerrjen e Aktgjykimit KI145/18, të 13 gushtit 2019. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata e Apelit konkludoi:

“Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e lartpërmendur vetëm ka konstatuar shkeljet procedurale të bëra nga Gjykata e Apelit mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsye e as që ka ofruar zgjidhje në lidhje me të drejtën materiale që aplikohet dhe duhet të aplikohet në raste të tilla kur kemi të bëjmë me kërkesa të palëve për fitim të pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore.

[...] aktgjykimi C. nr. 164/2003, në të cilin janë thirrur paditësit si devijim nga praktika e mëparshme, është e vërtetë se ka të bëj me rrethana të njëjta faktike dhe juridike por se nuk mund të konsiderohet se këto vendime paraqesin burim të së drejtës përkatësisht vendosja ndryshe nga këto vendime nuk do të thotë se ka devijim nga praktika gjyqësore. Vendimet e tilla nuk kanë ndërtuar praktikë gjyqësore për çështjen e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore, kjo pasi që këto vendime nuk kanë kaluar në të gjitha instancat gjyqësore përkatësisht nuk kanë kaluar në Gjykatën Supreme. Nuk kanë kaluar në Gjykatë Supreme pasi që paditësit kanë caktuar vlerën e objektit të kontestit më të ulët, gjë që ka paraqitur pengesë ligjore që kjo gjykatë ti trajtoj këto raste.

Praktika gjyqësore indirekt paraqitet si burim i të drejtës në rastet kur instancat më të larta gjyqësore, në një periudhë kohore më të gjatë në rastet e njëjta apo të ngjashme, sjellin vendime të njëjta. Për rastin e paditësve por edhe për rastet tjera që kanë të bëjnë me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në pronën shoqërore deri me tani nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Supreme që është vendosur në favor të saj. Gjykata Supreme është shprehur në mënyrë të qartë se me parashkrim fitues nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore ndërsa për ndryshimet ligjore që janë bërë në vitin 1996 afati i parashkrimit për pronën shoqërore fillon të rrjedhë vetëm pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 1996. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës është ajo që ka kompetencë ligjore që të përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës e jo gjykatat e instancave më të ulëta.

Në këtë rast Gjykata e Apelit vlerëson se deri me tani, jo vetëm për rastin e paditësve por edhe për rastet e tjera kur kërkohet pronësia me parashkrim fitues në pronën shoqërore, është qëndrimi i shprehur në vendimet e Gjykatës Supreme se në pronën shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Në rrethana të tilla rezulton se vendosja në këtë mënyrë nuk paraqet ndryshim të qëndrimit juridik apo devijim nga praktika e deritanishme gjyqësore por se respektim të vendimeve të instancës gjyqësore

më të lartë dhe normave juridike që rregullojnë çështjen e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore“.

38. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016, vlerësoi edhe pretendimet ankimore të përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjen e fitimit të së drejtës përmes parashkrimit fitues, duke konstatuar se:

“Për fitimin e të drejtës së pronësisë në mënyrë komulative duhet të plotësohen dy kushtet ligjore, të ekzistojë baza e vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë (nenin 20 i ligjit të lartpërmendur), por përveç kësaj e drejta e pronësisë fitohet edhe me regjistrim në librat publike të patundshmërisë ose në mënyrë tjetër të përcaktuar me ligj (neni 33 i po këtij ligji). Nga kjo rrjedh se përveç bazës juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë duhet të ekzistojë edhe mënyra juridike e fitimit, e në këtë rast nuk ekziston nga fakti se patundshmëria ende evidentohet si pronësi shoqërore në emër të Komunës së Lipjanit.

Gjykata e shkallës së dytë e pranon vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se në bazë të institutit të parashkrimit fitues paditësit e parë nuk kanë mundur ta fitojnë të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese edhe pse me dispozitën e nenit 16 të Ligjit mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e LMTHPJ-së, “Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/26”, i cili ka hyrë në fuqi me 05.07.1996, është përcaktuar se fshihet neni 29 i këtij ligji, mirëpo kjo dispozitë nuk mund të aplikohet në këtë çështje konkrete juridike por eventualisht ka mundësi të aplikohet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në çështjen e paditësve kjo dispozitë nuk ka qenë në fuqi, kurse vlen parimi se në raportet juridike-civile aplikohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko-civil. Sipas këtyre dispozitave duke marrë edhe për bazë dispozitat e Ligjit të Punës së Bashkuar, në rastin e paditësve, në asnjë rrethanë nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronë shoqërore sipas bazës së parashkrimit fitues. Përveç kësaj, paditësit kanë qenë dhe janë në dijeni të faktit se e paditura paluajtshmërinë ua ka dhënë vetëm në shfrytëzim, ndërsa pronar ka mbetur e paditura, siç edhe rezulton nga provat e administruara. Kjo është një rrethanë që argumenton faktin se në rastin e paditësve mungon mirëbesimi në posedim, si kusht për fitimin e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues, pasi që ata kanë qenë në dijeni se pronar i paluajtshmërisë është e paditura ndërsa ata e kanë vetëm të drejtën e shfrytëzimit. Nga këto arsye rezulton se paditësit e parë nuk kanë plotësuar kushtet ligjore për fitim të pronësisë mbi bazën e parashkrimit as sipas kushteve të përcaktuara nga neni 28 i LMTHJP-së“.

39. Më 24 janar 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit kundër Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016 të Gjykatës së Apelit të 10 dhjetorit 2019.

40. Më 5 shkurt 2020, Prokuroria e Shtetit i dërgoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës Njoftimin KMLC. nr. 18/2020, në të cilin thuhet: “Pas shqyrtimit të propozimi juaj dhe shkresave të lëndës, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ju njofton se propozimi juaj nuk është aprovuar, sepse në këtë çështje nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të

ligjshmërisë sipas nenit 247 par. 247.1 pika b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore“.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës në rastin KI49/20

41. Parashtruesja edhe në kërkesën KI49/20, pjesërisht ngre të njëjtat pretendime si në kërkesën KI145/18. Më konkretisht, parashtruesja e kërkesës pretendon se, *“Me këtë vendosje të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe atë E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm nga neni 31.1 dhe barazia para ligjit nga neni 24 të Kushtetutës dhe neni 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe neni 2 par. 1 pika a) i Ligjit Kundër Diskriminimit, sepse paditësit janë me përkatësi ashkalinjë – pakicë, ndërsa nga e njëjta (identike) bazë juridike – si refugjatë të Republikës së Shqipërisë, në të njëjtën kohë iu është dhënë në shfrytëzim paluajshmëria (shtëpia dhe tokë) dhe nga e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë familjes F.I. nga fshati Babush i Muhaxherëve, nga e njëjta bazë dhe nga e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë familjes E.M., A.M., A.M., A.M. dhe F.D., që të gjithë nga fsh. Bregu i Zi K. Lipjan, nga e njëjta bazë dhe e njëjta gjykatë iu është njohur e drejta e pronësisë edhe familjes Bresa nga Gracka e Vogël K. Lipjan, dhe nga baza identike për nga gjendja faktike dhe juridike, me vendim të plotfuqishëm i është njohur e drejta e pronësisë edhe paditëses Xh.H., nga fsh. Babush i Muhaxherëve, të cilat aktgjykime i janë bashkangjitur kërkesës së më hershme të dërguar në Gjykatë Kushtetuese (rasti nr. KI145/18 nr. ref. AGJ1408/14 Prishtinë më 13 gusht 2019) e që do ti bashkëngjiten edhe kësaj kërkesë, andaj shtrohet pyetja se a vlen ligji dhe dispozitat ligjore për të gjithë njësojë, apo për disa duhet interpretuar ndryshe ndërsa për disa të tjera ndryshe“.*
42. Në lidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës shton se përkundër Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18, ku ajo konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur nuk i adresoi siç duhet gjetjet kryesore të Gjykatës. Më konkretisht, Gjykata e Apelit nuk u përgjigj në gjetjet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me *“devijimin nga praktika e mëparshme gjyqësore lidhur me vendosjen për rrethana të njëjta faktike dhe juridike në rastet e ngjashme“.*
43. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës shton se vlerësimi i Gjykatës së Apelit në Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016 është i gabuar dhe se ai është në kundërshtim me konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese nga Aktgjykimi KI145/18, ku Gjykata Kushtetuese konstatoi, *“se e njëjta gjykatë (Gjykata e Apelit) në vendimet e saj të mëparshme për rastet identike nga gjendja faktike dhe juridike ka vendosur ndryshe, përkatësisht duke ua njohur të drejtën e pronësisë paditësve në ato konteste”.*
44. Parashtruesja pretendon se në Aktgjykimin e ri, Gjykata e Apelit gabimisht vlerësoi se vendimet e mëparshme nuk përbëjnë praktikë gjyqësore vetëm për faktin se nuk kishte vendosur edhe Gjykata Supreme, dhe se një vlerësim i tillë është i gabuar për faktin se këto vendime janë të plotfuqishme dhe vendimi i plotfuqishëm paraqet praktikë gjyqësore pavarësisht se cila instancë gjyqësore e ka nxjerrë atë dhe pavarësisht nëse ligjshmëria e tij është vlerësuar nga

Gjykata Supreme apo jo, me fjalë të tjera, Gjykata e Apelit e kontestoi vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, duke vlerësuar nëse vendimet e cituara nga Gjykata Kushtetuese përbëjnë praktikë gjyqësore apo jo. Gjykata e Apelit si duket ka ngatërruar praktikën gjyqësore me mendimet juridike të dhëna nga Gjykata Supreme.

45. Në fund, parashtruesja e kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që ajo të deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga neni 31.1 dhe të barazisë para ligjit nga neni 24 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar dhe të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C. nr. 19/2015, të 11 nëntorit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019, ose të kthejë çështjen në rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]“

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në

shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI MBI MARRËDHËNIET THEMELORE JURIDIKE PRONËSORE (në zbatim prej 8 shkurtit 1980 deri më 26 qershor 1996)

„[...]”

“2. Fitimi i së drejtës së pronësisë

Neni 20

E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.

E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj.

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me këqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ka ditur as që ka mundur taa dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 29

[I fshirë]

Neni 33

Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

46. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.

47. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

48. Gjykata gjithashtu i referohet edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

49. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata së pari thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të 10 dhjetorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ajo pretendon se i janë shkelur në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e

- përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
50. Gjykata gjithashtu përcakton nëse kërkesa e parashtrueses i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara në paragrafin (3) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
51. Dhe në fund, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

52. Gjykata fillimisht rikujton se ajo tashmë në rastin KI145/18 kishte vendosur një herë për të njëjtat pretendime të parashtrueses së kërkesës dhe në atë rast konstatoi shkeljen dhe ktheu rastin në Gjykatën e Apelit në rigjykim. Gjykata e Apelit, në procedurën e përsëritur, nxori Aktgjykimin e ri Ac. nr. 530/2016, për të cilin parashtruesja përsëri konsideron se me të njëjtin cenohen të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, e të cilat ajo i ndërlihd vetëm me mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18.
53. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës pretendon, *“se përkundër Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18, ku ajo konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur nuk i adresoi siç duhet gjetjet kryesore të Gjykatës. Më konkretisht, Gjykata e Apelit nuk u përgjigj në gjetjet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me “devijimin nga praktika e mëparshme gjyqësore lidhur me vendosjen për rrethana të njëjta faktike dhe juridike në rastet e ngjashme“.*
54. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata në rastin konkret duhet të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës në rrethanat e Aktgjykimit të ri Ac. nr. 530/2016 të Gjykatës së Apelit, të cilin kjo e fundit e kishte nxjerrë si rezultat i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/18. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht duhet të rikujtojë se cilat ishin konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës gjatë vlerësimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rastin KI145/18 në të cilin ajo konstatoi shkeljen.
55. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se në Aktgjykimin KI145/18, konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke u fokusuar në parimin e vendimit të paarsyetuar gjyqësor, për shkak se Gjykata e Apelit vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C. nr. 19/2015, të 11 nëntorit 2015, pa e adresuar fare pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me pohimet *“se gjykata e shkallës së parë ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme gjyqësore kur vendosi në rastet e familjeve të tjera në rrethana identike“.*

56. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin KI145/18 konstatoi se “pretendimi i parashtruesve të kërkesës për trajtim të pabarabartë nga ana e gjykatës së shkallës së parë – pavarësisht përgjigjes që do t’i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë do të përmbushej kushti i “palës së dëgjuar” dhe i administrimit të duhur të drejtësisë” (paragrafi 58 i Aktgjykimit KI145/18).
57. Prandaj, duke pasur parasysh këtë, mund të konkludohet se obligimi i Gjykatës së Apelit në procedurën e përsëritur ishte të ofrojë një përgjigje adekuate me të cilën në kuptimin thelbësor do të shpjegonte dhe qartësonte “nëse Gjykata Themelore ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme gjyqësore kur vendosi në rastet e familjeve të tjera në rrethana identike”.
58. Pikërisht në këtë drejtim, Gjykata, në rastin konkret, do të shqyrtojë Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 530/2016, të cilin kjo e fundit e kishte nxjerrë në procedurë të përsëritur, për të konstatuar nëse ajo i ka pranuar gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe nëse ka ofruar arsyetim adekuat i cili do të plotësonte parimet e vendimit të arsyetuar gjyqësor.
59. Gjykata rithekson se e drejta për një vendim të arsyetuar, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe zbatimi i saj, janë interpretuar nga GJEDNJ-ja në pajtim me praktikën e saj gjyqësore. Gjykata, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t’i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

60. Gjykata rikujton se e drejta për gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ ka përsëritur se, sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore e cila pasqyron parimin lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t’i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato mbështeten (shih rastet e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
61. Për më tepër, përderisa GJEDNJ-ja gjithashtu ka konsideruar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6.1 të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet “t’i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre” (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, kërkesa nr. 12945/87, Aktgjykimi i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).

62. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr. 49684/99, paragrafi 30, 27 shtator 2001, *Tatishvili kundër Rosisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58 dhe *Suominen kundër Finlandës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 37).
63. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1, obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument (shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994, paragrafi 61 dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).
64. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit (shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27, dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, *Ibidem*, paragrafi 42).
65. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsye për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët (shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; dhe *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59 dhe 60). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (rasti i GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr. 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30).
66. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur që, edhe pse një gjykatë vendore ka një liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtrësive të palëve, gjykata vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet e saj duke dhënë arsye për vendimin e saj (rasti i GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 36).
67. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, *Ibidem*, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtrësive të kërkesës duhet të adresohen (rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, paragrafi 63; *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6.

68. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konstaton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritave dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre (Gjykata Kushtetuese, rastet: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; dhe nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

(i) Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rastin e tanishëm

69. Parashtruesja e kërkesës pretendon se përkundër Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese në rastin KI145/18, në të cilin konstatoi se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur nxori Aktgjykimin e ri Ac. nr. 530/2016, në të cilin ajo sërish nuk i adresoi siç duhet gjetjet kryesore të Gjykatës Kushtetuese. Më konkretisht, Gjykata e Apelit nuk është përgjigjur në gjetjet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me *“devijimin nga praktika e mëparshme gjyqësore lidhur me vendosjen për rrethana të njëjta faktike dhe juridike në rastet e ngjashme”*.
70. Në mënyrë që Gjykata të përcaktojë bazueshmërinë e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, para së gjithash duhet të rikujtojë thelbin e gjetjeve të saj nga Aktgjykimi KI 145/18, dhe më pas të analizojë përgjigjen e Gjykatës së Apelit nga pjesa e Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016, të cilin e ka nxjerrë në procedurë të përsëritur.
71. Rrjedhimisht, Gjykata rikujton paragrafët 57 dhe 58 të Aktgjykimit KI145/18, të cilët përmbajnë konstatimet kryesore të Gjykatës në lidhje me thelbin e shkeljes së të drejtave të të parashtrueses nga kërkesa KI145/18.

57. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesve të kërkesës për trajtim të pabarabartë para gjykatave, i cili ishte ngritur para gjykatave të rregullta ishte thelbësor dhe i mbështetur me dëshmi materiale i cili ngrente çështje nga neni 24 i Kushtetutës, përkatësisht çështjen epabarazisë së palëve para ligjit. Adresimi i duhur i pretendimit në fjalë nga ana e gjykatave të rregulltado e forconte bindjen e parashtruesve të kërkesës se ata janë dëgjuar në mënyrë të duhur, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të Konventës .

58. Sikur Gjykata e Apelit të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesvetë kërkesës për trajtim të pabarabartë nga ana e gjykatës së shkallës së parë - pavarësisht përgjigjes që do t'i jepej këtij pretendimi (pra, pavarësisht nëse ky pretendim do të pranohej si i arsyetuar apo do të refuzohej si i pabazë), atëherë do të përmbushej kushti i “palës së dëgjuar” dhe i administrimit të duhur të drejtësisë.”

72. Është e qartë nga paragrafi i cekur 57 i aktgjykimit KI145/18 se Gjykata ka konstatuar se thelbi i shkeljes rezulton nga fakti se Gjykata e Apelit nuk e adresoi pretendimin e parashtrueses së kërkesës dhe nuk iu përgjigj pretendimit ankimor se Gjykata Themelore kishte devijuar nga praktika e mëparshme e saj në rastet me rrethana të njëjta juridike dhe faktike, dhe se në rastin e saj ka marrë një aktgjykim ndryshe. Sipas mendimit të kësaj gjykate, pikërisht ky pretendim ankimor ishte thelbësor dhe i rëndësishëm për parashtruesen e kërkesës, dhe mostrajtimi i tij nga Gjykata e Apelit ishte bazë për konstatimin e shkeljes.
73. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit ishte e obliguar që në procedurën e përsëritur të shqyrtonte në detaje dhe të jepte përgjigje nëse Gjykata Themelore në rastin e saj ishte shmangur nga praktika e saj e mëparshme kur ka vendosur në rastet e ngjashme.
74. Megjithatë, në mënyrë që Gjykata të vërtetojë nëse Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur i ka marrë parasysh konstatimet e Gjykatës Kushtetuese nga Aktgjykimi KI145/18, ajo do të shqyrtojë në vijim pikërisht pjesën e arsytimit të Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016, të Gjykatës së Apelit, të cilin ajo e ka nxjerrë duke iu përgjigjur konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese nga Aktgjykimi KI 145/18.

“[...] aktgjykimi C. nr. 164/2003, në të cilin janë thirrur paditësit, është e vërtetë se ka të bëjë me rrethana të njëjta faktike dhe juridike por se nuk mund të konsiderohet se këto vendime paraqesin burim të së drejtës përkatësisht vendosja ndryshe nga këto vendime nuk do të thotë se ka devijim nga praktika gjyqësore. Vendimet e tilla nuk kanë ndërtuar praktikë gjyqësore për çështjen e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues në rone shoqërore, kjo pasi që këto vendime nuk kanë kaluar në të gjitha instancat gjyqësore përkatësisht nuk kanë kaluar në Gjykatën Supreme. Nuk kanë kaluar në Gjykatë Supreme pasi që paditësit kanë caktuar vlerën e objektit të kontestit më të ulët, gjë që ka paraqitur pengesë ligjore që kjo gjykatë ti trajtoj këto raste.

Praktika gjyqësore indirekt paraqitet si burim i të drejtës në rastet kur instancat më të larta gjyqësore, në një periudhë kohore më të gjatë në rastet e njëjta apo të ngjashme, sjellin vendime të njëjta. Për rastin e paditësve por edhe për rastet tjera që kanë të bëjnë me fitimin e pronësisë me parashkrim fitues në pronën shoqërore deri më tani nuk ka asnjë vendim të Gjykatës Supreme që është vendosur në favor të saj. Gjykata Supreme është shprehur në mënyrë të qartë se me parashkrim fitues nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore ndërsa për ndryshimet ligjore që janë bërë në vitin 1996 afati i parashkrimit për pronën shoqërore fillon të rrjedhë vetëm pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 1996. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës është ajo që ka kompetencë ligjore që të përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës e jo gjykatat e instancave më të ulëta.

Në këtë rast Gjykata e Apelit vlerëson se deri me tani, jo vetëm për rastin e paditësve por edhe për rastet e tjera kur kërkohet pronësia me parashkrim fitues në pronën shoqërore, është qëndrimi i shprehur në vendimet e Gjykatës

Supreme se në pronën shoqërore nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Në rrethana të tilla rezulton se vendosja në këtë mënyrë nuk paraqet ndryshim të qëndrimit juridik apo devijim nga praktika e deritanishme gjyqësore por se respektim të vendimeve të instancës gjyqësore më të lartë dhe normave juridike që rregullojnë çështjen e fitimit të pronësisë me parashkrim fitues në pronë shoqërore”.

75. Duke analizuar gjetjet nga aktgjykimi KI145/18 me përmbajtjen e pjesës së arsytimit të Gjykatës së Apelit të Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016, mund të konkludohet se arsyetimi i Gjykatës së Apelit në thelb shkon në favor të pretendimeve për shmangie nga praktika në lidhje me fitimin e të drejtave nëpërmjet parashkrimit fitues, gjë që Gjykata sigurisht nuk e konsideron më pak të rëndësishme. Megjithatë, në rrethanat në fjalë, ai si i tillë nuk është me rëndësi vendimtare në kuptim të eliminimit të shkeljeve të identifikuar të cilat janë paraqitur nga Gjykata në Aktgjykimin KI145/18. Ajo që nuk mund të shihet në arsyetimin e dhënë është trajtimi i gjetjes kryesore të Gjykatës nga paragrafi 57 i aktgjykimit KI145/18, në lidhje me nxjerrjen e *“vendimeve të ndryshme nga Gjykata Themelore në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike”*.
76. Më konkretisht, nga pjesa e arsytimit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, pa mëdyshje mund të konstatohet se Gjykata e Apelit as në procedurën e përsëritur nuk është marrë me pretendimin kryesor ankimor të parashtrueses së kërkesës, dhe prandaj nuk ka dhënë përgjigje për të, që rrjedhimisht do të thotë se as nuk i ka shqyrtuar konstatimet e Gjykatës nga aktgjykimi KI 145/18.
77. Andaj, Gjykata konsideron se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016 sërish e shpërfilli tërësisht çështjen kryesore për të cilën është dashur të jepte një arsyetim, edhe pse ajo ishte specifike, relevante dhe e rëndësishme për parashtruesen e kërkesës. Në këto rrethana, mund të thuhet se një arsyetim i tillë, siç është përpiluar në Aktgjykimin e ri, para së gjithash nuk është në përputhje me gjetjet e Aktgjykimit KI145/18, dhe për këtë arsye si i tillë nuk është as në pajtim me detyrimet nga neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, paragrafi 25).
78. Për më tepër, duke shqyrtuar vetë thelbin e arsytimit të Aktgjykimit Ac. nr. 530/2016 të Gjykatës së Apelit, në lidhje me gjetjet e Gjykatës nga Aktgjykimi KI145/18, krijohet përshtypja se Gjykata e Apelit, ose nuk e kishte të qartë se në cilin drejtim do të duhej të shkonte arsyetimi i Aktgjykimit të ri në raport me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, ose, që Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj KI145/18 nuk ka shpjeguar në mënyrë mjaft të qartë udhëzimet që duhet të ndiqen nga Gjykata e Apelit.
79. Rrjedhimisht, Gjykata në këtë Aktgjykim do të shfrytëzojë mundësinë për të qartësuar më gjerësisht gjetjet e saj nga Aktgjykimi i mëparshëm KI145/18, duke i dhënë kështu Gjykatës së Apelit mundësinë për t'i arsyetuar ato më qartë në një aktgjykim të ri. Në mbështetje të kësaj, Gjykata shton se arsyetimi

i Gjykatës së Apelit duhet të ndjekë vetë thelbin e pretendimeve të parashtrueses së kërkesës për çështjen e cila lidhet me “*devijimin nga praktika e mëparshme gjyqësore lidhur me vendosjen në rrethanat e njëjta faktike dhe juridike në rastet e ngjashme*”.

80. Konkretisht, Gjykata e Apelit në procedurën e përsëritur duhet t'i shtjellojë më në detaje gjetjet e Gjykatës për çështjen e shmangjes së Gjykatës Themelore nga praktika e saj e mëparshme në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, përkatësisht të japë arsytetime më të detajuara për çështjen **i)** nëse ka pasur trajtim dhe vendimmarrje ndryshe të Gjykatës Themelore në rrethanat e ngjashme faktike dhe juridike; **ii)** nëse për një vendimmarrje të tillë, në qoftë se ka ekzistuar një e tillë, ekzistojnë justifikime të arsyeshme, **iii)** çfarë është synuar të arrihet me vendimet e tilla të ndryshme, në qoftë se ato janë nxjerrë nga Gjykata Themelore, dhe **iv)** për çfarë arsye në rastin e parashtrueses së kërkesës, në qoftë se ka ekzistuar një e tillë, është bërë shmangia nga praktika e mëparshme.
81. Bazuar në gjitha ato që u thanë më lart, duhet të konkludohet se Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016, nuk e ka përmbushur kushtin i cili garanton “një gjykim të drejtë” në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6. paragrafi 1 të KEDNJ-së, sepse mungon një vendim i arsyetuar në lidhje me gjetjet e Gjykatës në Aktgjykimin KI145/18.
82. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se ky konkluzion i referohet ekskluzivisht Aktgjykimit të kontestuar Ac. nr. 530/2016 të Gjykatës së Apelit, nga këndvështrimi i nivelit të arsytimit të saj në lidhje me pretendimet thelbësore të parashtrueses së kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.
83. Përfundimisht, Gjykata konsideron se në rrethanat konkrete nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e parashtrueses së kërkesës sipas nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, pasi që Gjykata për herë të dytë konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

84. Gjykata konstaton se me faktin se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj të dytë Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019, nuk i adresoi gjetjet e Gjykatës nga Aktgjykimi në rastin nr. KI145/18, në mënyrë të drejtpërdrejtë cenohet e drejta e parashtrueses së kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtrueses së kërkesës për herë të dytë iu mohua e drejta për një vendim të arsyetuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (1) (a) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TA SHPALLË, TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 530/2016 të 10 dhjetorit 2019;
- IV. TA KTHEJË Aktgjykimin Ac. nr. 530/2016 e Gjykatës së Apelit të 10 dhjetorit 2019, në rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit që, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën deri më 1 korrik 2022 lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje deri në përmbushjen e këtij urdhri;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve.
- VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani